Një arsye pse po ndodh ngërçi politik mund të jetë edhe mos interesimi i bashkësisë ndërkombëtare që Hashim Thaçi të jetë sërish pjesë e qeverisë. Kështu konstaton analisti Naim Rashiti, derisa thirret në një kujtim të tij si përkthyes.

Ish zyrtari i Grupit Ndërkombëtar të krizave  (ICG) tregoi se pse ndërkombëtarët nuk e donin Ramush Haradinajn në qeveri bashkë me LDK-në pas zgjedhjeve të vitit 2004. “Kanë pa se përmes mbajtjes së PDK-së në qeveri e kontrollojnë procesin jashtë qeverisë, grupet e caktuara, komandantët rajonal. Kishte frikë se PDK do të sillej si e rebeluar jashtë institucioneve”, tha Rashiti për Klan Kosova.

Rashiti tregoi pse Ibrahim Rugova zgjodhi Haradinajn e jo Thaçin atëherë. “Ramush Haradinaj ishte më i besueshëm për shumë arsye, një partneritet më i menaxhueshëm politik dhe ishte rrjedhë e një balance kundër PDK-së për të marrë një krah të luftës”, tha ai.

10 vjet më pas preferenca që të huajt kishin për liderin e PDK-së kanë ndryshuar. Naim Rashiti vlerëson se kryeministri në detyrë nuk është njeriu që doemos ndërkombëtarët duan ta shohin në krye të qeverisë. “Faktori ndërkombëtar është i dedikuar kësaj here të lejojnë zgjidhje demokratike sipas procedurës kushtetuese për formim të institucioneve dhe janë shumë pak të brengosur se kush do të bëhet Kryeministër”, tha ai.